



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Tiranë, më \_\_\_\_\_

Dokument parlamentar

**V E N D I M**

**Nr. /2020**

**PËR SHPALLJEN E VAKANCËS SË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË  
INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE  
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Në mbështetje të nenit 11, pika 3, dhe nenit 12, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar dhe nenit 111, të Rregullores së Kuvendit,

**KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E  
NJERIUT**

**V E N D O S I:**

- I. Shpalljen e vakancës së Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
- II. Të ftohen për paraqitjen e kandidaturave për Inspektor të Përgjithshëm, individët që:
  - a) janë shtetas shqiptar;
  - b) kanë mbaruar arsimin e lartë juridik ose ekonomik në profilin financë, Diplomë e Nivelit të Dytë;
  - c) kanë vjetërsi në profesion, si jurist ose ekonomist financier, jo më pak se 15 vjet;
  - d) nuk janë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
  - e) nuk janë anëtarë të partive politike, deputet, ministër, zëvendësministër, pjesëtar në strukturat e Policisë së Shtetit, Forcat e Armatosura dhe Shërbimin Informativ Shtetëror.
- III. Shërbimet e Kuvendit të shpallin dhe të bëjnë publike vakancën në faqen zyrtare të Kuvendit. Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë propozimin e kandidaturës, për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ligjore.
- IV. Afati i paraqitjes së kandidaturave të propozuara, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, përfundon 20 ditë nga data e publikimit të këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

**KRYETAR**

**Ulsi MANJA**